



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.134/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.03.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së BOE “XH&M” shpk & “Ndregjoni” shpk, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-94424-11-15-2018 me objekt “*Rikonstruksion i Sheshit Taulantia Bashkia Durrës*”, me fond limit 362.816.046 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 17.12.2018 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues:

BOE “XH&M” shpk & “Ndregjoni” shpk
Njësia Bashkiake nr.5, rruga Zef Jubani, pallati i ri -9 katësh,
nr.12, hyrja.2, ap.3 Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga “Sami Frashëri”, Nr.10, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e*

rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga BOE ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. BOE ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së BOE ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 15.11.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-94424-11-15-2018 me objekt “*Rikonstruksion i Sheshit Taulantia Bashkia Durrës*”, me fond limit 362.816.046 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 17.12.2018 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 17.12.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 14.01.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

ALB-BUILDING	pa oferte	I skualifikuar
EVEREST	pa oferte	I skualifikuar
B-93	pa oferte	I skualifikuar
SAKULI	pa oferte	I skualifikuar
ISOBAR CONSTRUCTION	pa oferte	I skualifikuar
A & E ENGINEERING	pa oferte	I skualifikuar
2T	pa oferte	I skualifikuar
Alba Konstruksion	pa oferte	I skualifikuar
LALA	pa oferte	I skualifikuar
Kevin Construction	275,634,844	I skualifikuar
XH & M	251,457,317	I skualifikuar
DELTA LAVORI S.P.	278,221,219	I skualifikuar
VELLEZERIT HYSA	245,828,961	I skualifikuar
BE - IS SH.P.K	284,308,036	I kualifikuar
G.P.G. COMPANY	288,263,002	I kualifikuar
ARIFAJ	305,160,223	I kualifikuar
SALILLARI	313,524,480	I kualifikuar
CURRI	321,503,054	I kualifikuar

II.4. Në datën 14.01.2019 BOE “XH&M” shpk & “Ndregjoni” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

1. *Ne marreveshjen e bashkepunimit ndermjet dy shoqerive nuk jane percaktuar punet konkrete qe do te kryeje secila shoqeri, ne perputhje me nenin 74, pika 2 te VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku shprehimisht citohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës”. Per rrjedhoje, duke qene se per disa nga kerkesat per kualifikim shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur behet ne raport me punet konkrete qe merr persiper secili anetar i bashkimit, komisioni i vleresimit te ofertave e ka te pamundur te procedoje me shqyrtimin e detajuar te gjithe dokumentacionit.*
2. *Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk ka paraqitur grafikun e detajuar te punimeve duke parashikuar vleren e plote te punimeve pa tvsh per cdo muaj, sic eshte kerkuar ne shtojcen 13 te Dokumentave te Tenderit. Grafiku i paraqitur eshte i pa plotesuar.*
3. *Shoqeria “Xh&M” shpk nuk ploteson piken 2.3.2 per kualifikim lidhur me numrin minimal te te punesuarve, pasi, bazuar ne dokumentacionin e paraqitur, rezulton se numri i te punesuarve te kesaj shoqerie eshte: Prill: 32, Maj: 34, Qershor: 41, Korrik: 51, Gusht: 85, Shtator: 52 dhe Tetor: 48. Bazuar ne perqindjen e puneve qe ka marre persiper sipas marreveshjes se*

bashkëpunimit (55%) duhet te kete minimalisht 47 persona dhe nuk ploteson per muajt prill, maj dhe qershor.

- 4. Shoqëria "Ndregjoni" shpk nuk ploteson piken 2.3.8 per kualifikim lidhur me disponimin e pikave te kerkuara te licenses, pasi nuk ploteson germen E per NP4 dhe germen B per NP 8. Duke qene se nuk jane percaktuar punet qe do te kryeje secila shoqeri dhe nuk ploteson kete kerkese, komisioni konsideron se nuk plotesohet kushti per kualifikim.*

II.5. Në datën 18.01.2019 BOE ankimes ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- 1. Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit nënvizojmë se në shtojcën 12 kriteret e përgjithshme të kualifikimit pjesë të DT të procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor nuk është parashikuar dorëzimi i një forme të vecantë të bashkëpunimit, kontratë dhe prokurë në rast të paraqitjes së ofertës nga grup i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Megjithëse nga ana e autoritetit tuaj kontraktor në Kriteret e Përgjithshme të pranimit kualifikimit nuk është kërkuar disponueshmëria e kontratës së bashkëpunimit e për rrjedhojë bazuar në nenin 55 pika 2 e LPP nuk duhet të përdoret asnjë kriter që nuk është përfshirë në dokumentat e tenderit. Oferta jonë nuk mund të skualifikohet pasi kemi të bëjmë me një kriter të pakërkuar (në DT të procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk është kërkuar dorëzimi i kontratës së bashkëpunimit), megjithatë sqarojmë se BOE jonë është krijuar me anë të kontratës noteriale nr.1080 rep dhe nr.376 kol datë 11.12.2018 hartuar para noterit publik.*

Së dyti nga shqyrtimi në themel i kontratës lehtësisht konstatohet se në nenin 3 të saj ndër të tjera parashikohet: Shoqëria XH&M shpk merr përsipër realizimin në masën 55% të punimeve. Shoqëria Ndregjoni shpk merr përsipër realizimin në masën 45 % të punimeve. Gjithashtu në nenin 8 të kontratës ndër të tjera është parashikuar edhe përgjegjësia brenda bashkimit të operatorëve ekonomikë ku ndër të tjera thuhet: Të dyja palët do të jenë së bashku dhe në mënyrë individuale përgjegjëse për ekzekutimin e kontratës në përputhje me termat e kontratës. Në rastin konkret detyrimi i vetëm ligjor që duhet zbatuar në mënyrë që kjo kontratë bashkëpunimi të konsiderohet e vlefshme konsiston në deklarin në përqindje të punëve si dhe zërave konkret të preventivit të punimeve që secili operator ekonomik merr përsipër të kryej. Konstatojmë se në nenin 74 pika 2 e VKM 914 datë 29.12.2014 në asnjë rast nuk ndalohe mundësia e ndarjes së secilit zë të kryerjes së punimeve në përqindje të caktuar pra 45 % dhe 55 % në rastin konkret. Nënvizojmë se në rastin konkret kontrata jonë e bashkëpunimit dhe ndarja e përqindjeve mes operatorëve ekonomikë nuk i përket rastit klasik ku grupe operatorësh ekonomikë elementë specifikë , grupe zërash punimesh në pjesmarrjen në cilësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë por në rastin tonë të gjithë zërat e punimeve (secili zë) është ndarë në masën 45% dhe 55%. Një ndarje e tillë nuk është e ndaluar nga ligji bazuar edhe në parimin juridik se çfarë nuk është e ndaluar është e lejuar . Duke qenë në kushtet kur nga ana e BOE pjesmarrës janë ndarë secili zë i punimeve në masën 45% dhe 55% ipso facto nuk lind e drejta dhe detyrimi që të përcaktohet në tërësi në kontratën e bashkëpunimit të secilit

zë të ndahet në mënyrë të vecantë. Ne kemi plotësuar të gjitha kriteret në përputhje me përqindjen e marrë përsipër. Në rastin konkret mangësia e pretenduar përfshihet në kategorinë e devijimeve të vogla në kuptim të ligjit devijim i cili është i bazuar mbi argumenta tekniko – ligjorë ku për sa kohë që është ndarë secili zë i preventivit në masën 45 dhe 55 % e shprehur qartë në nenin 3 dhe 8 të kontratës duke mos lënë vend për ekuivok atherë ky devijim nuk ndryshon karakteristikat e kontratës së bashkëpunimit e cila përmban të gjitha elementët ligjorë, hartuar para noterit nënshkruar nga palët dhe ndarë secili zë punimesh në përputhje me % e bashkëpunimit.

2. Në lidhje me arsyen e dytë të skualifikimit gjykojmë se nuk është e mbështetur në ligj dhe në fakte ndaj nuk qëndron. Në shtojcën 12 kriteret e vecanta të kualifikimit kapaciteti teknik të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk është parashikuar se duhet të dorëzohet grafiku i punimeve. Konstatojmë se oferta e shoqërisë sonë është skualifikuar referuar një kriteri të pakërkuar. Në asnjë rast nuk është kërkuar dorëzimi i Grafikut të Punimeve dhe akoma më tej sipas një formati të caktuar ku të pasqyrohet edhe vlera e punimeve. Megjithatë nuk është kërkuar BOE ka dorëzuar në SPE preventivin e punimeve me të njëjtën përmbajtje të përcaktuar nga AK dhe në të njëtin format. Grafiku i punimeve është printuar në formatin bardhe e zi e për rrjedhojë kuadratet e mbushur me të verdhë janë një ngjyrë më të zbehtë por kjo nuk do të thotë që ky grafik është dorëzuar bosh dhe i paplotësuar. Printimi dhe Uploadimi në format bardhe e zi nuk është ndaluar as nga APP referuar manualit 1 të vitit 2018. Nënvizojmë se kontrata e mësipërme nuk është një kontratë prokurimi me celsa në dorë por një procedurë ku është përcaktuar projekti teknik dhe afatet e zbatimit nga ana e AK dhe operatorët ekonomikë me pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik kanë marrë përsipër të gjitha kushtet e kontratës dhe garës.
3. Në lidhje me arsyen e tretë të skualifikimit gjykojmë se nuk është e mbështetur në ligj dhe në fakt ndaj dhe nuk qëndron. Në shtojcën 12 kriteret e vecanta të kualifikimit kapaciteti teknik është kërkuar: Të ketë të punësuar minimalisht 85 (tetëdhjetë e pesë) persona për periudhën Mars 2018 – tetor 2018, të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për kete periudhë, shoqeruar me formularët e listepagesave E-SIG. Në përmbushje të këtij kriteri anëtari i BOE XH&M shpk ka dorëzuar Vërtetim nr.T00711819 datë 07.12.2018 për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore me anë të së cilës vërtetohet se mesatarja e numrit të punësuarve për periudhën e kërkuar është 47.2 punonjës. Reefruar përqindjes së bashkëpunimit të marrë përsipër (55%) dhe numrit mesatar të punonjësve të kërkuar prej 85% rezulton se anëtari i BOE duhet të dëshmojë një punësim mesatar prej 46.75 punonjës ku referuar vërtetimit të lëshuar nga administrata tatimore rezulton se disponon 47.2 punonjës numër mesatar.

4. Në lidhje me arsyen e katërt të skualifikimit gjykojmë se nuk është e mbështetur në ligj dhe në fakte ndaj nuk qëndron. Në shtojcën 12 kriteret e vecanta të kualifikimit kapaciteti teknik të DT është parashikuar se:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N.P – 1. A Punime gjermimi në tokë. N.P – 4. E Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. N.P - 7. A Ujsjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje. N.P – 8. B Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë. N.P – 11. B Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. N.P – 12. B Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N.S – 1. A Punime për prishjen e ndërtimeve N.S – 6. A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese. N.S – 9. C Punime strukturorë speciale. N.S - 13. A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. N.S- 15. A Pastrimi i ujrave detarë, liqenor dhe lumor. N.S – 18. B Punime topogjeodezike.

Në përmbushje të kriterëve të vecanta të kualifikimit nga ana e anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomikë XH&M shpk&Ndrejoni shpk, Ndrejoni shpk është dorëzuar Licencë NZ 1982/17 ku konstatohet se për kategoritë NP4 disponon kategorinë D dhe NP 8 kategorinë A.

Referuar edhe tabelës sqaruese në rast se do të marrim në shqyrtim secilin element të punimeve të marrë nga anëtari i BOE Ndrejoni shpk të cilat i korenspondojnë tërësisë së punimeve të përfshira në kategorinë NP 4 dhe NP 8 referuar kjo edhe përqindjes së bashkëpunimit të marrë përsipër nga ky anëtar i BOE është 164,700,000.

Referuar lidhjes 4 të Vendimit nr.42 datë 16.01.2008 të KM niveli i shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për cdo kategori punimi

D 101-200 milion lekë

Në rastin konkret totali i punimeve të marra përsipër nga anëtari i BOE Ndrejoni shpk sipas preventivit të marrë përsipër është 164,700,000 për punime të kategorisë NP 4 që i korenspondon klasës D , të njëjtën klasë që ai disponon në licencë.

Referuar edhe tabelës sqaruese nëse do të marrim në shqyrtim secilin element të punimeve të marrë përsipër nga anëtari i BOE Ndrejoni të cilat i korenspondojnë tërësisë së punimeve të përfshira në kategoritë NP 8 referuar kjo edhe përqindjes të marrë përsipër nga ky anëtar është 10,639,069.

Referuar lidhjes 4 të Vendimit nr.42 datë 16.01.2008 të KM niveli i shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për cdo kategori punimi .

A (edhe për herë të parë) 0-20 milion lekë.


Në rastin konkret totali i punimeve në marra përsipër nga Ndregjoni shpk është 10,639,069 për punime të kategorisë NP 8 që i korenspondon klasës A të njëjten klasë që ai disponon në licencë.

Sa më sipër kërkojmë pranimin e ankesës.

II.6. Në datën 23.01.2019 me shkresën nr. 95/1 prot BOE ankimues është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 01.02.2019 BOE ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjten objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.95/3 prot datë 06.02.2019 protokolluar me tonën me nr.153/2 datë 08.02.2019 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.



pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “XH&M” shpk & “Ndregjoni” shpk” për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre me arsyetimin se “*Ne marreveshjen e bashkepunimit ndermjet dy shoqerive nuk jane percaktuar punet konkrete qe do te kryeje secila shoqeri, ne perputhje me nenin 74, pika 2 te VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku shprehimisht citohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës”. Per rrjedhoje, duke qene se per disa nga kerkesat per kualifikim shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur behet ne raport me punet konkrete qe merr persiper secili anetar i bashkimit, komisioni i vleresimit te ofertave e ka te pamundur te procedoje me shqyrtimin e detajuar te gjithe dokumentacionit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Operatorët ekonomikë “XH&M” sh.p.k & “Ndrejoni” kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit lidhur para një noteri publik Nr.1080 Rep, Nr.376 Kol datë 11.12.2018. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar për realizimin e objektit “Rikonstruksion i Sheshit Taulantia Bashkia Durrës”,

Referuar kontratës së mësipërme të bashkëpunimit parashikohet se [...]Neni 3-Pjesmarrja e palëve në grup do të përcaktohet sipas këtyre raporteve: Shoqëria XH&M merr përsipër realizimin e punimeve në masën 55% . Shoqëria Ndrejoni shpk merr përsipër realizimin e punimeve në masën 45%. Neni 5- Të dy palët do të ofrojnë të gjitha mjetet logjistike , kapacitetet ekonomike , financiare, si dhe eksperiencën e tyre si një grup i vetëm pavarësisht nga pjesmarrja për realizimin sa më efikas të kontratës. Neni -8 Të dyja palët do të jenë së bashku dhe në mënyrë individuale përgjegjëse për ekzekutimin e kontratës në përputhje me termat e kontratës. ..

III.1.2. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se :

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen nëbashkimin eoperatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

III.1.3 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, K.P.P. konstaton se në marrëveshjen e bashkëpunimit por edhe në ofertë/preventivin e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk janë parashikuar në mënyrë të detajuar elementët konkretë të shërbimit që do të kryejë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues. Referuar nenit 74 pika 1 të aktit normativ në zbatim të ligjit VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se në ofertë duhet të

përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se marrëveshja e bashkëpunimit dhe oferta e dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk përmbush një prej kushteve kryesore të parashikuar nga VKM 914/2014.

Komisioni sqaron se ndarja e zërave konkretë është një kërkesë e parashikuar në aktin normativ si më sipërcituar dhe është një faktor i rëndësishëm mbi të cilin autoriteti kontraktor bën verifikimin dhe shqyrtimin e përmbushjes së secilit kriter të përcaktuar në dokumentat e tenderit, me dokumentacionin e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik, gjithnjë në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Në rastin konkret është përcaktuar vetëm përqindja e pjesmarrjes në bashkëpunim për secilin nga anëtarët e bashkimit por në ofertë/preventivin e paraqitur dhe as në marrëveshjen e bashkëpunimit nuk rezulton ndarja e zërvave dhe elementëve konkretë të punimeve që do të realizojë secili prej tyre.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për vërtetimin e krijimit të bashkimit dhe konkretisht kontrata e bashkëpunimit në të cilën nuk është bërë ndarja konkrete e zërave të punimeve objekt prokurimi, nuk është hartuar në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, duke bërë të pamundur verifikimin e plotësimit të dokumentacionit të paraqitur nga secili anëtar i këtij bashkimi në përputhje me përqindjen e marrë përsipër.

III.1.4. Pretendimin e ankimuesit se skualifikimi është bërë mbi një kriter të pakërkuar duke argumentuar se *“në shtojcën 12 kriteret e përgjithshme të kualifikimit pjesë të DT të procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor nuk është parashikuar dorëzimi i një forme të vecantë të bashkëpunimit, kontratë dhe prokurë në rast të paraqitjes së ofertës nga grup i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Megjithëse nga ana e autoritetit tuaj kontraktor në Kriteret e Përgjithshme të pranimit kualifikimit nuk është kërkuar disponueshmëria e kontratës së bashkëpunimit e për rrjedhojë bazuar në nenin 55 pika 2 e LPP nuk duhet të përdoret asnjë kriter që nuk është përfshirë në dokumentat e tenderit. Oferta jonë nuk mund të skualifikohet pasi kemi të bëjmë me një kriter të pakërkuar (në DT të procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk është kërkuar dorëzimi i kontratës së bashkëpunimit), KPP e gjen të pabazuar pasi forma e pjesmarrjes në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokuruese është e përcaktuar shprehimisht në ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të saj dhe nuk lë vend për konfuzion. Në këtë kuptim KPP gjykon se BOE ankimues ka pasur detyrimin ligjor të paraqesë kontratën e bashkëpunimit, ofertë preventivin në përputhje me përcaktimet ligjore duke përcaktuar në to pjesën e punës që do të realizojë secili prej tyre në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratë.*

III.1.5. Gjithashtu sa i takon pretendimit të BOE ankimues se secili anëtar i bashkimit ka marrë përsipër të realizojë konkretisht 55% të të gjithë zërave të preventivit dhe anëtari tjetër 45% të të gjithë zërave të preventivit KPP gjykon se një përfundim i tillë nuk rezulton të jetë i shprehur qartësisht në kontratën e bashkëpunimit të lidhur mes palëve pasi në asnjë rast nuk citohet se nga anëtarët e bashkimit janë marrë përsipër 55% dhe 45% të të gjithë zërave të preventivit.

KPP gjykon se vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë bëhet mbi bazën e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike dhe jo në bazë të interpretimeve që bëhen pas fazë së dorëzimit të ofertave për të kuptuar se çfarë kanë dashur palët të shprehin në kontratë. Në rastin konkret KPP gjykon se në kontratën e bashkëpunimit nuk rezulton të jetë thënë shprehimisht se të dy

anëtarët e BOE kanë marrë përsipër të realizojnë të gjithë zërat e preventivit në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratë.

Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me LPP.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron

III.2. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “XH&M” shpk & “Ndregjoni” shpk” për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së tyre me arsyetimin se “Shoqeria “Ndregjoni” shpk nuk plotëson pikën 2.3.8 për kualifikim lidhur me disponimin e pikave të kerkuara të licenses, pasi nuk plotëson germen E për NP4 dhe germen B për NP 8. Duke qene se nuk janë përcaktuar punët që do të kryejë secila shoqëri dhe nuk plotëson këto kërkesë, komisioni konsideron se nuk plotësohet kushti për kualifikim”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 12 “kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.8 “kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- 2.3.8 Operoret ekonomike duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këto duhet të paraqesin licencën perkatese të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara në sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:
 -
 - Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme:
 - N.P – 1. A Punime gërmimi në tokë. N.P – 4. E Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. N.P - 7. A Ujshjellësa, gazshjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje. N.P – 8. B Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë. N.P – 11. B Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. N.P – 12. B Punime të inxhinierisë së mjedisit.
 - Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licencat e mëposhtme: N.S – 1. A Punime për prishjen e ndërtimeve N.S – 6. A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese. N.S – 9. C Punime strukturorë speciale. N.S - 13. A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. N.S- 15. A Pastrimi i ujrave detarë, liqenor dhe lumor. N.S – 18. B Punime topogjeodezike.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se në përmbushje të kriterit sa më sipër BOE ankimues kanë paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Licencë NZ.1981/17 e shoqërisë “Ndregjoni” shpk nga ku rezulton se për punime të kategorisë NP-4 operatori zotëron nivelin D të licencës, ndërsa për kategorinë NP-8 zotëron kategorinë A të licencës.
- Licencë NZ.2979/8 e shoqërisë “XH&M” shpk nga ku rezulton se për punime të kategorisë NP-4 operatori zotëron nivelin G të licencës, ndërsa për kategorinë NP-8 zotëron kategorinë D të licencës.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

III.2.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji*

III.2.5. Në nenin 26 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.2.6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” , i ndryshuar, në lidhjen 2 “Kategorizimi sipas punimeve të zbatimit të ndërtimit” që i bashkëlidhet këtij vendimi parashikon:

N.P. 4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe

artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

N.P. 8 Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë: Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta të realizuara në ujëra të ëmbla ose të kripura, që i përkasin terminaleve “ujore” ose vepra mbrojtëse territori nga ujërat detare ose të ëmbla, e kompletuar me veprat lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe të tipit të veçantë për të pasur një shërbim të mirë të përdoruesit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar portet, molet, bankinat, panelet, platformat, pontilet, mbrojtje detare, shkëmbinj nënujore, ujësjellësit nënujore, vepra shkarkimi, si edhe punime të drenimit e thellimi në det të hapur, në pellg ujëmbledhës, të mbrojtjes kundër erozionit nga ujërat e ëmbla ose të kripura

III.2.7. Në Lidhjen 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi” të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, parashikohet:

NIVELI I SHOQËRISË	SIPAS VLERAVE NË LËKË TË PUNIMEVE TE KRYERA PËR CDO KATEGORI PUNIMI
<i>A (edhe për herë të parë)</i>	<i>0-20 milion lekë</i>
<i>B</i>	<i>21-50 milion lekë</i>
<i>C</i>	<i>51-100 milion lekë</i>
<i>D</i>	<i>101-200 milion lekë</i>
<i>E</i>	<i>201-400 milion lekë</i>
<i>F</i>	<i>401-800 milion lekë</i>
<i>G</i>	<i>mbi 800 milion lekë</i>

III.2.8. Referuar parashtrimeve në ankesë BOE ankimes pretendon se “Referuar edhe tabelës sqaruese në rast se do të marrim në shqyrtim secilin element të punimeve të marrë nga anëtari i BOE Ndrejoni shpk të cilat i korenspondojnë tërësisë së punimeve të përfshira në kategorinë NP 4 dhe NP 8 referuar kjo edhe përqindjes së bashkëpunimit të marrë përsipër nga ky anëtar i BOE është 164,700,000. Referuar edhe tabelës sqaruese nëse do të marrim në shqyrtim secilin element të punimeve të marrë përsipër nga anëtari i BOE Ndrejoni të cilat i korenspondojnë tërësisë së punimeve të përfshira në kategorinë NP 8 referuar kjo edhe përqindjes të marrë përsipër nga ky anëtar është 10,639,069. KPP konstaton se në sistemin e prokurimeve elektronike nuk ka asnjë tabelë sqaruese mbi ndarjen e zërave ndërmjet anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes. Kjo tabelë është bashkëngjitur ankesës pas fazës së dorëzimit të ofertave dhe në këtë kuptim nuk mund

të konsiderohet në këtë fazë të procedurës pasi vlerësimi i operatorëve ekonomikë bëhet bazuar në dokumentacionin që ndodhet në sistemin e prokurimeve elektronike në datën e hapjes së ofertave.

KPP gjykon se është pikërisht mungesa e ndarjes së zërave konkretë në kontratën e bashkëpunimit apo edhe në preventivin e ofertës sikundër analizuar në pikën III.1 e në vijim, ajo që e bën të pamundur vlerësimin e kritereve në përputhje me përqindjen e pjesmarrës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues. Rëndësia e përcaktimit të zërave konkretë që do të kryejë secili nga anëtarët e bashkimit qëndron pikërisht në përmbushjen e kritereve në atë masë apo në proporcion me atë që është marrë përsipër të realizohet nga secili prej tyre. Mungesa e një elementi të tillë con në konfuzion dhe e bën gati të pamundur procesin e vlerësimit të kapaciteteve të anëtarëve të bashkimit. Në këtë kuptim KPP gjykon se në kushtet kur BOE nuk ka detajuar zërat konkretë të punimeve për secilin prej anëtarëve e ka bërë të pamundur verifikimin e kapacitetit teknik lidhur me disponimin e kategorive të licencave konkretisht të kategorisë NP-4 dhe NP-8 për sicilin prej anëtarëve të bashkimit.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “XH&M” shpk & “Ndrejoni” shpk” për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre me arsyetimin se *“Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk ka paraqitur grafikun e detajuar të punimeve duke parashikuar vlerën e plote të punimeve pa tvsh për cdo muaj, sic është kërkuar në shtojcën 13 të Dokumentave të Tenderit. Grafiku i paraqitur është i pa plotësuar”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 13 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi është përcaktuar si më poshtë:

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Projekti i plote, përfshire specifikimet teknike, janë ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimit, bashkëngjitur dokumentave të tenderit.

Grafiku i Punimeve: Jepet në sistemin elektronik të prokurimit, bashkëngjitur dokumentave të tenderit.

III.3.2. Në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton të jetë ngarkuar grafiku i punimeve të objektit të prokurimit, ku jepet i detajuar afati i ekzekutimit për secilën kategori punimesh.

III.3.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se BOE ankimues ka dorëzuar grafikun e punimeve i cili rezulton i palpotësuar, dhe jo sipas grafikut të cilin ka ngarkuar autoriteti kontraktor në SPE, duke mos dhënë informacion të saktë mbi afatet e ekzekutimit të kontratës sipas grafikut të dhënë për cdo muaj.

III.3.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i*

vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

III.3.5. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.3.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Referuar grafikut të punimeve të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga autoriteti kontraktor kuptohet qarte se është kërkuar paraqitja e nje grafiku punimesh i cili duhet të pasqyrojë në mënyrë të detajuar afatet/periudhën e ekzekutimit për çdo kategori punimesh.

Në grafikun e punimeve të paraqitur nga ankimesi mungon pasqyrimi në mënyrë grafike se kur do të realizohen kategoritë e punimeve për secilin muaj. Në këtë kuptim KPP gjykon se operatori ekonomik duhet të kishte paraqitur të njëtin model grafik punimesh sikundër është kërkuar nga autoriteti kontraktor, duke krijuar një panoramë të qartë mbi afatet brenda të cilave BOE do të realizojë zërat konkretë të kategorive të punimeve.

KPP gjykon se në procedurat e prokurimit me objekt “punë publike” ndryshe nga procedurat e prokurimit që kanë për objekt “mall” ose “shërbim”, shtojca 1 “formulari i ofertës” për këto procedura nuk përmban kolonën e fundit me emërtim “Afati”, pasi një elementë tillë e zëvendëson garfiku i punimeve i cili është i detyrueshëm për tu paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësuar dhe i detajuar , për ti dhënë garanci autoritetit kontraktor se këto afate janë të pranuar nga operatorët pjesëmarrës. KPP gjykon se dokumenti i paraqitur nga BOE nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor i si i tillë nuk mund të konsiderohet i vlefshëm në këtë procedurë prokurimi. Është detyrë e operatorëve ekonomikë të paraqesin të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentat e tenderit në përputhje me të gjitha kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në të.

Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me LPP.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “XH”&”M” shpk& “Ndregjoni” shpk për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-94424-11-15-2018 me objekt “*Rikonstruktion i Sheshit Taulantia Bashkia Durrës*”, me fond limit 362.816.046 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 17.12.2018 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 153 Protokoli; Datë 01.02.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

MENDIM KUNDËR

Ne, anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik (në vijim KPP), Lindita Skeja dhe Merita Zeqaj, jemi kundër arsyetimit të shumicës si dhe dispozitivit të vendimit, për sa i përket ankesë me objekt: *“Rikonstruksion i Sheshit Taulantia Bashkia Durrës”*, me fond limit 362.816.046 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 17.12.2018 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me palë ankimuese bashkimin e operatorëve ekonomikë XH&M” shpk & “Ndregjoni” shpk.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetojmë

I.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, në zbatim të nenit 30 pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, në të cilin parashikohet se *“1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”*, nisur nga rëndësia e veprës që do të bëhet, interesi publik që ajo ka, objekti i prokurimit, vlera e lartë e investimit të kësaj procedure prokurimi, referuar edhe ankesës së paraqitur nga ankimuesi për veprimet e paligjshme të autoritetit kontraktor në lidhje me dokumentat e procedurës së prokurimit, gjykojmë të ndalemi fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

I.1.1. Marrë shkas nga arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomikë ankimues, nga verifikimi i kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, të bazë të të cilave është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, konstatojmë se referuar dy prej arsyeve të skualifikimit të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues lidhet me mos dorëzimin e kontratës së bashkëpunimit mes palëve në përputhje me formën e kërkuar nga neni 74 i Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar si edhe me plotësimin e numrit të punonjësve për periudhën e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

I.1.2. Referuar shtojcës 12 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”*, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar se: *“2.3.2 Të ketë të punësuar minimalisht 85 (tetëdhjetë e pesë) persona për periudhën Mars 2018 – tetor 2018, të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për këte periudhë, shoqeruar me formularët e listepagesave E-SIG”*

Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”

Në nenin 26 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 26 pika 8 gërma “b” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet se: “8. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

I.1.3. Sa më sipër analizuar, gjykojmë se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e vecantë të vendosur. Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit si edhe një prej arsyeve të skualifikimit të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes, konstatojmë se konkretisht në lidhje me disponueshmërinë e fuqisë punëtore autoriteti kontraktor ka parashikuar se operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar minimalisht 85 (tetedhjetë e pese) persona për periudhën Mars 2018 – tetor 2018, të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për kete periudhë, shoqeruar me formularët e listepagesave E-SIG” gjykojmë se disponueshmëria e fuqisë punëtore përbën element kyç në procesin e vlerësimit të kapaciteteve teknike të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe kriteri i mësipërm shfaq një rëndësi të veçantë, pasi me pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë kapacitetet organizative dhe fuqinë e nevojshme punëtore për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në rastin konkret, konstatojmë se kriteri i mësipërm i vendosur nga autoriteti kontraktor është lënë evaziv duke mos përcaktuar qartësisht nëse numri prej 85 punonjësish si dëshmi e fuqisë punëtore do të llogaritet mbi bazën e mesatares mujore për periudhën e kërkuar, ose në rast se kërkesa e autoritetit kontraktor shtrihet mbi një numër ekzakt minimal mbi disponueshmërinë e fuqisë punëtore të kërkuar. Vetë autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.95/1 protokollit datë 23.01.2019 në trajtimin e ankesës së

bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, ndër të tjera argumenton se: “ *Në kriterin e vendosur nga AK dallohet qartë që nuk është kërkuar numri mesatar i punonjësve për periudhën Mars 2018-Tetor 2018. Autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të kenë të punësuar minimalisht 85 (tetëdhjetë e pesë) persona për periudhën Mars 2018-tetor 2018 që do të thotë që për çdo muaj OE duhet të ketë të punësuar minimalisht 85 punonjës”.*

I.1.4. Sjellim në vëmendje se tre parimet kryesore të përzgjedhjes së ofertës fituese në procedurat e prokurimit publik janë ato të mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve. Gjykojmë se në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor duhet të udhëhiqet nga zbatimi i tre parimeve të mësipërme të përzgjedhjes së ofertës fituese. Në zbrëthimin ligjor në drejtim të hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, tre parimet e mësipërme nënkuptojnë njëherazi se kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të hartohen sa më qartë, mos shkaktojnë konfuzion në procesin e hartimit të ofertave nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, paqartësi në procesin e vlerësimit të ofertave si edhe të shqyrtimit të ankesave nga vetë komisioni i shqyrtimit të ankesave të ngritura pranë autoritetit kontraktor. Vlen të theksohet se, kriteret e kualifikimit, nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt prokurimi me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jo diskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit. Sa më sipër, mospërcaktimi i saktë i kriterit të mësipërm, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimin të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit, pasi përcaktimi i këtij kriteri si më sipër cituar, ka shkakuar konfuzion dhe gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave për komisionin e vlerësimit të ofertave. Rrjedhimisht, hartimi i kriterit në këtë mënyrë ka krijuar konfuzion si tek operatorët ekonomikë ashtu edhe tek komisioni i vlerësimit të ofertave për vlerësimin e tyre. Tashmë Komisioni i Prokurimit Publik ka konsoliduar praktikën e tij, ku në rastet e konstatimit të paligjshmërisë në drejtim të hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, kriteret të cilat krijojnë konfuzion për palët në process dhe janë të paqarta, atëherë, udhëhequr nga parimi i transparencës, barazisë dhe mos diskriminimit ka vendosur për anulimin e procedurës së prokurimit, si në rastin e vendimit KPP 107/2019.

I.2. Gjithashtu, konstatojmë se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues është skualifikuar edhe referuar arsyes të mos dorëzimit të kontratës së bashkëpunimit mes palëve në përputhje me formën e kërkuar nga neni 74 i Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

I.2.1. Në lidhje me këtë arsye, gjykojmë ti drejtohem fillimisht “Kritereve të Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit” ku, konstatojmë se është parashikuar se: “*“Shtojca 12 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT Ofertuesi duhet të deklarojë se: a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse” b) nuk është*

*në proces falimentimi, (statusi aktiv) b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP, c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur. *** Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8. Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër”*

I.2.2. Nga shqyrimi i Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit/Pranimit të publikuar në shtojcën 12 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstatojmë se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është vendosur asnjë kriter dhe mënyrë e përmbushjes dhe dorëzimit të dokumentacionit në rastet kur oferta dorëzohet nga grupe operatorësh ekonomikë, kjo në përputhje me nenin 44 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 74 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Në nenin 55 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “ *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*” Sjellim në vëmendje se tre parimet kryesore të përzgjedhjes së ofertës fituese në procedurat e prokurimit publik janë ato të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve. Gjykojmë se me pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik, operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë të detyruar të nënshtrohen rregullave të vendosur në dokumentet e procedurës së prokurimit, kritereve të veçanta të kualifikimit. Me pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik, për operatorët ekonomikë nuk shfaqet e nevojshme dijeni e plotë e çdo rregullimi ligjor dhe nënligjor në fushën e prokurimeve publike, por, këto të fundit duhet të dëshmojnë se plotësojnë kriteret e veçanta të kualifikimit dhe ato të përgjithshme të pranimit të vendosur nga autoriteti kontraktor. Si masë mbrojtëse, ligjvënësi ka parashikuar pikërisht në nenin 55 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar se në skualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit” Në rastin konkret, konstatojmë *prima facia* se në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk ka asnjë parashikim në lidhje me mënyrën e dorëzimit të ofertës në rast se kjo e fundit paraqitet nga një grup operatorësh ekonomikë të cilët ofertojnë në cilësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë.

I.2.3. Në lidhje me mënyrën e hartimit të Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit/Pranimit, konstatojmë se bazuar në nenin 13 pika 2 gërma “ç” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin

publik” të ndryshuar ku parashikohet se: “Agjencia e Prokurimit Publik: ç)harton dokumentet standarde të tenderit, që do të përdoren në procedurat e prokurimit, sipas rregullave të prokurimit publik”.

Në nenin 10 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar parashikohet se: “APP-ja përgatit formatin e dokumenteve standarde të tenderit, që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit. Këto dokumente japin informacion që ka lidhje me objektin e kontratës dhe llojin e procedurës, i cili plotësohet, në çdo rast, nga autoritetet kontraktore. Gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor përdor dokumentet standarde sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike ose kundrejt pagesës, në rastet kur vlerësohet nga autoriteti kontraktor në procedurat e prokurimit që nuk kërkojnë njoftim publik, sipas nenit 38 të LPP. Në çdo rast, emrat dhe numri i operatorëve ekonomikë, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të tenderit apo këqyrjen e tij duhet të mbahen sekret.”

I.2.4. Konstatohet se procedura e prokurimit objekt ankimi e përzgjedhur nga autoriteti kontraktor është “Procedurë e Hapur” me mjete elektronike për kryerjen e “Punëve Publike”. Me anë të Vendimit nr.2 datë 10.01.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Për miratimin e dokumenteve standarde të tenderit për procedurën “Procedurë e Hapur” për furnizimin e mallrave, shërbimeve dhe kryerjen e punëve” janë miratuar edhe dokumentet standarde të tenderit të cilat duhet të përdoren nga të gjithë autoritetet kontraktore që zhvillojnë procedurat të prokurimit publik. Konkretisht, konstatohet se vetëm në dokumentet standarde të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur” për kontratat e “Punëve Publike” Agjencia e Prokurimit Publik nuk ka parashikuar asnjë kriter të përgjithshëm të kualifikimit/ pranimit në lidhje me mënyrën e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës në rast se kjo e fundit dorëzohet nga grupe bashkimit operatorësh ekonomikë, ndërsa në dokumentet standarde të procedurës së prokurimit “E Hapur” për “Shërbime” dhe “Mallra” të miratuara po me anë të Vendimit nr.2 datë 10.01.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Për miratimin e dokumenteve standarde të tenderit për procedurën “Procedurë e Hapur” për furnizimin e mallrave, shërbimeve dhe kryerjen e punëve” në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit/Pranimit është parashikuar se: “Vec kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen: a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; b. Prokura e posaçme.”.

I.2.5. Gjithashtu me anë të Vendimit nr.1 datë 10.01.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Për miratimin e dokumenteve standarde të tenderit për procedurën “Kërkesë për Propozime” për furnizimin e mallrave, shërbimeve dhe kryerjen e punëve” në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit/Pranimit të dokumenteve standarde të tenderit “Kërkesë për Propozime” për “Punë” “Mallra” “Shërbime” është parashikuar se: “Vec kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen: a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; b. Prokura e posaçme.” I njëjti parashikim shfaqet edhe në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit/Pranimit të dokumenteve standarde të tenderit “Negocim pa shpallje paraprake të Njoftimit të Kontratës” për “Punë” “Mallra” “Shërbime të

miratuara me anë të Vendimit nr.3 datë 11.01.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Për miratimin e dokumenteve standard të tenderit për procedurën “Me Negoocim pa Shpallje Paraprake të Njoftimit të Kontratës” për furnizimin e mallrave, shërbimeve dhe kryerjen e punëve”. I njëjti parashikim, pra se “Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; b. Prokura e posaçme.” Shfaqet edhe në dokumentet e procedurës së prokurimit “Me Negoocim me Shpallje Paraprake të Njoftimit të Kontratës” për furnizimin e mallrave, shërbimeve dhe kryerjen e punëve” të miratuara me anë të Vendimit nr.4 datë 11.01.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Për miratimin e dokumenteve standard të tenderit për procedurën “Me Negoocim me Shpallje Paraprake të Njoftimit të Kontratës” për furnizimin e mallrave, shërbimeve dhe kryerjen e punëve”.

I.2.6. Në rastin konkret, gjykojmë se mungesa e një rregullimi specifik në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi në lidhje me mënyrën e dorëzimit të ofertës në rast se kjo e fundit paraqitet nga grup bashkimesh operatorësh ekonomikë në dokumentet e procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur” “Punë Publike” ka krijuar paqartësi si për operatorët ekonomikë pjesëmarrës të cilët nga njëra anë janë të detyruar të përgatisin ofertën në përputhje me dokumentet e procedurës së prokurimit dhe si e tillë nuk mund të skualifikohen nga një procedurë prokurimi referuar një kriteri të pa kërkuar dhe nga ana tjetër për autoritetet kontraktore në cilësinë institucioneve përgjegjës për zhvillimin e procedurave të prokurimit bazuar në nenin 12 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar të cilët kanë një rol kyç në procesin e vlerësimit të ofertave në përputhje me dokumentet e procedurës, ligjin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Nga ana tjetër konstatojmë se nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik ka tashmë një rregullim specifik për të gjithë llojet e tjera të procedurave të prokurimit për çdo tip kontrate (përfshirë edhe kontratën për punë publike) si më sipër arsyetuar ku është shprehur qartë se *Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; b. Prokura e posaçme,* një parashikim i cili mungon tek DST “Procedurë e Hapur” “Punë”, megjithëse referuar nenit 30 pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar Procedura e Hapur është procedura e preferuar në prokurimet. Marrë shkas dhe nga objekti i ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, gjykojmë se një mungesë e parashikimit vetëm në DST “Procedurë e Hapur” “Punë” ka sjellë konfuzion tek operatorët ekonomikë dhe tek autoritetet kontraktore. Bazuar në nenin 11 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” ku parashikohet se : “Komisioni bashkëpunon me autoritetet shtetërore duke ruajtur pavarësinë dhe autonominë e tij” duke qenë se çështja e mësipërme nuk është në kompetencën e Komisionit të Prokurimit Publik, por ky i fundit me indicje nga ankimuesi ka konstatuar boshëllëkun e rregullimit administrativ, i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik të ri shqyrtojë DST e Procedurës së Hapur, Punë me qëllim shmangien e paqartësive dhe konfuzionin mes pjesëmarrësve aktorëve dhe faktorëve në procedurat e prokurimit publik.

I.2.7. Bazuar në nenin 64, pika 3 të LPP – së, gjykojmë se situata konfuzë e krijuar nga mospërcaktimi i qartë i kriterëve për kualifikim sa më sipër arsyetuar, përbën shkak për anulimin e kësaj procedure

prokurimi. Në nenin 31, pika 2 gërma “d” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, parashikohet se: “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së prokurimit [...]”.

Sa mësipër, Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vlerësuar mbi kriteret e paqarta, evazive dhe të hartuara jo në përputhje me nenin 26/8 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar , mbi të cilat ka bërë edhe vlerësimin dhe kualifikimin/skualifikimin e operatorëve ekonomikë, si edhe në kushtet kur në dokumentet e procedurës së prokurimit nuk ka asnjë arashikim në lidhje me natyrën e dokumentacionit i cili duhet dorëzuar në rast se oferta paraqitet nga grupe operatorësh ekonomikë, gjykojmë se, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes nuk duhet të merreshin në shqyrtim në themel, pasi procedura e prokurimit duhet të anulohet për shkaqet e sipërcituara.

Anëtare
Lindita Skeja



Anëtare
Merita Zeqaj